



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL  
DREJTORIA E TRAJNIMIT DHE LICENSIMIT

Nr. 980 prot.

Tiranë, më 15 . 4 .2024

**VENDIM**

Nr. 35 , datë 15 . 4 .2024

**PËR  
MIRATIMIN E DHËNIES SË PËRJASHTIMIT**

Në zbatim të Ligjit nr. 96/2020 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, Ligjit nr. 53/2022 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Aviacionit Civil”, VKM Nr. 1095, datë 24.12.2020 “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, Urdhrit të Ministrit Nr. 218, datë 29.12.2023 “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e rregullave të detajuara në lidhje me pranimin e certifikatave të pilotëve nga vendet e tjera”, në vijim të kërkesës Nr. Prot. 04-109, datë 19.03.2024 të Operatorit Ajror Air Albania Sh.p.k, Autoriteti i Aviacionit Civil analizoi rrethanat (*sipas ACAA-DLS-EXMP-101 dhe ACAA-DLS-EXMP-102*) dhe:

Nisur nga sa më sipër,

**V E N D O S A**

1. Dhënien e përjashtimit “Për zgjatjen përtej vitit të dytë të vlefshmërisë së validimit të licencave të pilotëve të lëshuara nga vende që nuk janë vende të BE-së”, nga pika 3 e nenit 4 të Urdhrit të Ministrit Nr. 218, datë 29.12.2023 “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e rregullave të detajuara në lidhje me pranimin e certifikatave të pilotëve nga vendet e tjera”.
2. Ky përjashtim zbatohet për pilotët e Operatorit Ajror “Air Albania Sh.p.k”:
  - Capt. Mojtapha Meshkin Kelk
  - F/O Deniz Havzali
  - F/O Ismail Faruk Kizilay
3. Ky përjashtim është subjekt i kushteve të mëposhtme:
  - Të informohet pa vonësë Autoriteti i Aviacionit Civil për çdo rezultat të trajnimit apo vlerësimit të kompetencës të kryer për pilotët subjekt i këtij përjashtimi.

- Pas hyrjes në fuqi të përjashtimit Air Albania duhet të aplikojë për zgjatjen e validimit të licencave të pilotëve subjekt i këtij përjashtimi. Periudha e zgjatjes së validimit do të jetë sa periudha e zgjatjes së përjashtimit.
- Operatori ajror Air Albania të marrë masa për punësimin e pilotëve sipas kërkesave rregullatore të Urdhrit të Ministrit Nr. 218, datë 29.12.2023 “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e rregullave të detajuara në lidhje me pranimin e certifikatave të pilotëve nga vendet e tjera”.

4. Ky përjashtim është në fuqi deri në datë 15.12.2024.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**DREJTOR EKZEKUTIV**

**Maksim Et'hemaj**

